



KUVENDI
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.04.2019, Ora 12.30

Drejton mbledhjen

Gramoz Ruçi - Kryetar i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”

Rendi i ditës:

Miratimi i Rezolutës “Për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” për vitin 2018 dhe për planin e veprimit për vitin 2019”

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Artemisa Dralo – Zëvendësministre e Europës dhe Punëve të Jashtme

Romina Kuko – Zëvendësministre e Brendshme

Zamira Gjini – përfaqësuese nga Ministria e Arsimit

Gentian Opre – përfaqësues nga Ministria e Financave

Arda Hoxha - përfaqësuese e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Arjana Pëllumbi – përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Delina Ibrahimaj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Institutit të Statistikave

Erinda Ballanca - Avokate e Popullit

Nejla Peka -Komisionere për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Gerti Janaqi – Drejtor i Institutit për Zhvillimin e Edukimit

Ina Lako –përfaqësuese e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Roberto de Bernardi – përfaqësues i UNICEF-it në Shqipëri

Maryne Bucher – përfaqësuese e Human Rights and Advocacy Officer the United Nations Resident Coordinator in Albania

Blerina Lako – Zëvendës drejtoreshë e Programit “World Vision Albania”

Julian Papaproko – përfaqësues i “World Vision Albania”

Emira Shkurt – përfaqësuese e UNICEF-it në Shqipëri

Elda Hallkaj – përfaqësuese e UNICEF-it në Shqipëri

Iva Zajmi – konsulente UNICEF-it në Shqipëri

Ermal Como – përkthyes i UNICEF-it

Klaudio Pulaha – përfaqësues i CRCA-së

Albana Mustafaraj – përfaqësuese e CRCA-së

Anila Meço – përfaqësuese e “Save the Children”

Edlira Shima – përfaqësuese e “Save the Children”

Linda Pino – përfaqësuese e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri, koordinatore kombëtare

Ervjola Osmanaj – përfaqësuese e Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN)

Delina Nano – përfaqësuese e Institute for the Promotion of Social and Economic Development

Esmeralda Dylgjeri – përfaqësuese e Shoqatës Vizion

Astrit Bajo – përfaqësues i YMCA-së

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar kolegë deputetë, pjesëtarë të grupit “Miqtë e fëmijëve”, përfaqësues të qeverisë, të shoqërisë civile dhe të partnerëve ndërkombëtarë, kam kënaqësinë që të hap këtë mbledhje të radhës të grupit “Miqtë e fëmijëve”.

Para se të vijojmë me rendin e ditës, do të dëshiroja t’ju rikujtoja rëndësinë e madhe që kanë për Kuvendin e Shqipërisë dhe jo vetëm, detyrimet që rrjedhin nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Kuvendi i Shqipërisë ka qenë gjithmonë i angazhuar për zhvillimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe ka mbajtur përgjegjësitë para qytetarëve shqiptarë, si edhe para bashkësisë ndërkombëtare për këtë angazhim.

Ky grup ka punuar dhe do të vazhdojë të punojë për zhvillimin dhe ndërmarrjen e politikave të vazhdueshme në mbrojtje të interesave të larta të fëmijëve.

Në punën e Kuvendit nëpërmjet ligjberjes dhe ushtrimit të kontrollit parlamentar jemi kujdesur të nxisim dhe të mbikëqyrim rritjen e standardeve të kujdesit shëndetësor, arsimor, shërbimet ligjore sociale dhe ekonomike në shërbim të fëmijëve. Në këtë kuadër ndër nismat e ndërmarra nga Kuvendi i Shqipërisë do të veçoja miratimin e ligjit për të drejtat e fëmijëve, që është miratuar në vitin 2017, miratimin i ndryshimeve ligjore për ngritjen e seksionit për të miturit pranë Avokatit të Popullit në vitin 2014, përmirësimin e ligjit për kujdesin shoqëror në vitin 2016, ndryshimet në Kodin Penal për dhënien e dënimit më të rëndë në rastet e veprave seksuale ndaj të miturve në vitin 2013, miratimin e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në vitin 2016, sigurimin e mbrojtjes më të mirë të të drejtave dhe të ligjeve për të drejtat e fëmijëve migrant dhe azilkërkues, miratimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijëve për shfrytëzimin ekonomik në vitin 2017, miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, miratimin e ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti në vitin 2017 dhe së fundi miratimin në seancën e kaluar plenare të rezolutës për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” për vitin 2018 dhe planin e veprimit për vitin 2019.

Kjo sigurisht është rezoluta e dytë për fëmijët që ka miratuar Kuvendi, me të cilat Shqipëria ka hedhur një hap tjetër pozitiv në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve që prej nënshkrimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara.

Tani, më lejoni të kthehem te tema kryesore e këtij takimi që është shqyrtimi dhe miratimi i raportit të pestë periodik “Për zbatimin e Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve”.

Unë e kam lexuar me vëmendje të veçantë këtë raport dhe shpresoj që me të njëjtën vëmendje dhe proukupacion ta keni lexuar të gjithë ju pjesëtarët e këtij grupi.

Që në fillim do të thosha se jam përgjithësisht dakord me raportin, por dëshiroj të bëj disa sugjerime.

Së pari, raporti ishte i detajuar kryesisht tek arritjet, por, nga ana tjetër, nuk nxjerr qartësisht në pah se cilat standarde dhe detyrime nuk janë realizuar, prandaj do t’i kërkoja grupit ndërmintor të punës të reflektojë me kujdes çështjet më problematike dhe të drejtat e pa realizuara të fëmijëve.

Përmirësimi të të drejtave të fëmijëve i shërbejmë jo thjesht duke bërë parada suksesesh, por duke njohur edhe mosrealizimet, duke e marrë kështu bashkë me to përgjegjësitë dhe duke programuar për të ardhmen realizimin e domosdoshëm të tyre.

Së dyti, gjetjet e raportit duhet të ballafaqohen më mirë me konventën për të drejtat e fëmijëve dhe rekomandimet e saj, të cilat duhet t’i shërbejnë si bazë hartimit, monitorimit dhe raportimit të çdo politike sektoriale. Në këtë mënyrë krijojmë një sinergji funksionale midis ligjeve që ndërmarrim, politikave që bëjmë dhe raportimeve që realizojmë.

Gjithashtu, rekomandoj që në strategjitë sektoriale, që tashmë janë në fazën e hartimit, si për shembull strategjia e arsimit, në fazën e monitorimit të adresojmë mosrealizimet që janë konstatuar nga vëzhgimet përmblendhëse të komitetit për të drejtat e fëmijëve në Gjenevë. Njëherësh dëshiroj të tërheq vëmendjen se të drejtat e fëmijëve janë një çështje me rëndësi kombëtare dhe një detyrë qeverisëse, por janë po aq edhe çështje komunitare e qeverisjes vendore dhe lokale. Besoj se edhe ju bini dakord se nga leximi i raportit bie në sy se pjesëmarrja e qeverisjes vendore për këtë raportim ka qenë dhe mbetet e kufizuar, edhe pse kërkesa për raportim u qarkullua dy herë. Shqetësimi për përfshirjen aktive të bashkive u ngrit edhe në seancën e kaluar të mbledhjes së grupit “Miqte e fëmijëve”, nga zoti Fino në mos gaboj. Për më tepër bashkitë duhet të mbajnë një peshë të rëndësishme për zbatimin e kësaj konvente.

Është me tepër rëndësi zgjidhja e këtij ngërçi, për më tepër koha në shqyrtimit të raportit duhet detyrimisht të jenë të grumbulluara informacione për përmbushjen e kësaj konvente në nivelin lokal.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore, shoqata e bashkive në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Këshillin Kombëtar dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të diskutojnë nëse realizimi i përgjegjësi të qeverisjes vendore për përmbushjen e rekomandimeve të Konventës, mund të përbente një çështje me vete apo të kanalizohet si një çështje e veçantë edhe nga grupi i deputetëve “Miq të fëmijëve”.

Gjithashtu, konstatoj se zbatim i rekomandimeve të konventës, sidomos në respektimin e protokolleve të bashkëpunimit mes profesionistëve dhe politikëbërësve, trajtohet në mënyrë të vakët e të cekët dhe ndoshta nuk pasqyron punën reale që është bërë. Sigurisht që raporti duhej të ishte dorëzuar pranë Sekretariatit të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve në Gjenevë, prandaj për ta kompensuar këtë vonesë Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme duhet t’ia paraqesë sa më shpejtë raportin për miratim Këshillit të Ministrave dhe më pas t’i përcillet menjëherë Komitetit në Gjenevë. Nga momenti i dorëzimit deri në shqyrtimin e raportit do të ketë një boshllëk kohor, i cili mund të zgjasë edhe 2 vjet. Për këtë arsye në kohën e shqyrtimit do të kërkohet të raportoni edhe arritjet për 2 vjetët e fundit, prandaj kërkohet që grupi ndërministror i punës, që ka hartuar raportin, të vazhdojë të mbetet aktiv dhe nën drejtimin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të monitorojë periodikisht vëzhgimet përmbledhëse të Komitetit deri në shqyrtimin përfundimtar të këtij raporti.

Përpos këtyre nismave dhe shumë të tjerave të ndërmarra gjatë viteve, dëshiroj të inkurajoj grupin për veprimtarinë e mëtejshme gjatë këtij viti dhe për vitin që vjen. Këto veprimtari të përfshijnë jo vetëm avancimin e angazhimeve për trajtimin e problematikave të fëmijëve, për plotësimin në vazhdimësi të detyrave që rrjedhin nga Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, por edhe për çështje të tjera si këto që do t’ju them më poshtë:

- Si dhe sa duhet të kufizohet koha që fëmijët ndjekin me teknologji dhe në ekran në favor të kohës për lojëra, lexime apo të jetës së gjallë me njëri-tjetrin, si dhe sa duhet të kufizohet lundrimi i fëmijëve në botën virtuale në favor të zbritjes së tyre në botën reale.

- Çfarë duhet të bëjmë që të kufizojmë dëmin që shkakton teknologjia në raport me sjelljen sociale të fëmijëve.

- Çfarë duhet bërë që shkollat shqiptare të harmonizojnë përdorimin e teknologjisë moderne me metodat tradicionale, të cilat mundësojnë dhe edukojnë dije dhe norma të qëndrueshme.

- Si mësuesit, po ashtu edhe prindërit duhet të rivendosin raportet e famshme të bashkëpunimit që ka trashëguar shkolla shqiptare dhe të mos i lënë fëmijët nën pushtetin e tabletave.

- Si të prezantojnë ushqimin dhe të kufizojnë rrezikun e obezitetit të fëmijët.

- Si mund të bashkëpunojmë të gjithë që t'i armiqësojmë fëmijët shqiptarë me drogat dhe rreziqet e tjera të shoqërisë së sotme.

- Si mund të kufizojmë format e rënda të punës së fëmijëve, përfshirë këtu të miturit e detyruar dhe të bindim veten, shoqërinë dhe institucionet se fëmijët janë konsumatorë dhe jo prodhues të të mirave materiale, pra janë përfitues dhe jo sponsor të sistemit tonë të mirëqenies.

- Si t'i çlirojmë ata nga stresi që u krijojmë jo vetëm me burimet e pamjaftueshme për një mirëqenie me standarde të larta, por edhe me sjelljen brutale politike, ku qëllojnë jo rrallë politikanët njëri-tjetrin apo në politikanët institucionet.

- Çfarë modelesh për jetën u ofrojnë fëmijëve shqiptarë ekranet dhe mediet shqiptare, blogjet, seksicizmi, pasurimi nëpërmjet forcës apo librit, punën dhe argëtimin në një shoqëri të shëndetshme.

Mjaft prej këtyre çështjeve, sigurisht që e tejkalojnë kornizën e këtij raporti, por njëherazi janë brenda kornizës së rritjes, të ushqyerjes, të shëndetit, të shkollimit, të argëtimit dhe edukimit të fëmijëve shqiptarë.

Këto ishin ato që kisha si fillim.

Fjalën po ia kaloj zotit Roberto de Bernardi, përfaqësues i UNICEF-it në Shqipëri.

Roberto de Bernardi – Faleminderit!

Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Dua të falënderoj fillimisht Shkëlqesinë e Tij, kryetarin e Kuvendit, zotin Ruçi, por edhe anëtarët e tjerë që janë të pranishëm në këtë tryezë, zonjat ministre, zëvendësministrat, kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, si dhe të gjithë grupin parlamentar “Miqte e Fëmijëve”. Kur them fjalën grup, nuk e kam vetëm për grupin parlamentar “Miqte e Fëmijëve”, por edhe për përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, persona që advokojnë dhe që përkrahin të drejtat arsimore edhe të institucioneve të tjera.

Nuk dua të harroj asnjërin prej jush, sepse keni qenë aleatë shumë të denjë dhe të fuqishëm të Shqipërisë, të qeverisë, të UNICEF-it për të gjitha institucionet që i konsiderojnë fëmijët si prioritet. Nuk dua të harroj as anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, të cilët janë të pranishëm këtu sot, për gjithë kontributin e tyre që kanë dhënë gjatë gjithë këtij procesi, i cili u përshkrua mjaft mirë nga Kryetari i Kuvendit.

E fundit, por jo nga rëndësia, kolegët dhe miqtë e Kombeve të Bashkuara, të cilët janë të pranishëm sot këtu. Nga këndvështrimi i UNICEF-it kjo mbledhje është shumë e rëndësishme jo vetëm për arsyet që u përshkruan kaq qartë nga ana e Kryetarit të Kuvendit, por edhe për arsyen se viti 2019 do të jetë përvjetori i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, i cili përfaqëson ndoshta atë që përfaqëson edhe vetë Kushtetua për të gjitha vendet. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është si një Kushtetutë për Shqipërinë, por, siç jua thashë më sipër, edhe për vendet e tjera.

Dua t'ju kujtoj se gjatë 30 vjetëve të fundit bota ka ndryshuar në mënyrë dramatike dhe nuk është ashtu siç ka qenë para shumë viteve. Gjatë këtyre viteve bota nuk ka përjetuar ndryshime kaq drastike nga këndvështrimi teknologjik...

(Mungesë incizimi)

Këto nene janë të përditësuara dhe vazhdojnë të përfaqësojnë atë që duhet të bëjnë njerëzit për të siguruar që fëmijët të rriten, të zhvillohen, të kontribuojnë për zhvillimin e çdo vendi. Ditët e sotme është shumë e rëndësishme të shohim Konventën për të Drejtat e Fëmijëve edhe për sinergjinë që kjo konventë mund të ketë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, sepse edhe qeveria e Shqipërisë i ka përkrahur këto objektiva. Këtu mund të kemi një bashkëpunim dhe përforsim midis objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe sinergjisë së Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe në rastin e Shqipërisë është një element i tretë që është akoma më i rëndësishëm nga i cili ne do të përfitojmë, pikërisht procesi drejt aderimit në Bashkimin Europian.

Unë nuk besoj se procesi drejt aderimit të BE-së nuk mund të kryhet dhe nuk do të jetë i suksesshëm pa realizimin e plotë të të drejtave të fëmijëve dhe arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Kryetari i Kuvendit na kujtoi shumë mirë procesin e hartimit të draftit të parë të këtij raporti, i cili duhet dorëzuar pranë komisionit të ekspertëve për të drejtat e fëmijëve. Unë, si përfaqësues i UNICEF-it, dua të përgëzoj Kryetarin e Kuvendit dhe grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve” për kujdesin që kanë treguar në këtë proces! Gjithashtu, dua të shfrytëzoj rastin të

përgëzoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për aftësinë e treguar në koordinimin e një pune të tillë, si dhe për mbulimin e aspekteve teknike për të gjitha këto rekomandime.

E fundit, por jo nga rëndësia, dua të falënderoj të gjitha institucionet shtetërore qeveritare, të cilat kanë dhënë një kontribut dhe bashkëpunim të shkëlqyer! Unë i përmenda më parë organizatat e shoqërisë civile, por dua t'i përmend edhe një herë, sepse mendoj se ato janë një aspekt shumë i rëndësishëm i këtij procesi. Unë mendoj se ka disa produkte, që janë të rëndësishme jo vetëm për cilësinë që mbart ai produkt, por edhe për procesin që është kryer për të arritur në këtë produkt përfundimtar. Unë besoj se ky është një shembull tipik i asaj që dua të them. Sigurisht, raporti duhet të jetë i një cilësie të lartë, por në të njëjtën kohë është shumë e rëndësishme që procesi të ndiqet për të arritur te produkti përfundimtar. Unë besoj se Shqipëria nuk ka harruar (kjo ka ndodhur falë kontributit nga shumë organizata të shoqërisë civile dhe institucione të tjera) të dëgjojë zërat e të rinjve, ndaj ky raport është përfutur edhe nga rinjtë, të cilët kanë pasur mundësi të shprehen lidhur me të drejtat e tyre në vend. Unë mendoj se të rinjtë shqiptarë kanë shqetësimet, shpresat dhe mendimet e tyre për situatën aktuale e kështu me radhë.

Nëse do t'u referohemi edhe një herë fjalëve të Kryetarit të Kuvendit, ai na rikujtoi se nuk është keq që ne të përqendrohemi tek arritjet dhe te historitë e suksesit, por do të ishte mirë dhe e drejtë që ne t'i kujtojmë vetes se çfarë duhet të bëjmë më shumë, cilat janë boshllëqet që duhet të plotësojmë dhe cilat janë fushat ku ka nevojë për përmirësime.

Një fushë që unë dua të përmend, e cila, në fakt, është përmendur edhe në rekomandimin e përgatitur nga komisioni në vitin 2012 lidhur me situatën e fëmijëve në Shqipëri, është çështja e alokimit të buxhetit. Edhe pse në terma absolutë, krahasuar edhe me QEV-në ose gjendjen e pasurisë së vendit, buxheti nuk është i vogël, përsëri Shqipëria vazhdon të jetë mbrapa krahasuar me vendet e BE-së, me vendet e tjera të rajonit, si dhe me vendet e Ballkanit Perëndimor. Pra, Shqipëria është mbrapa në çështjet, si: mbrojtja sociale, shëndetësia, arsimit, të cilat duhet të alokohen nga buxheti i fëmijëve. Sigurisht, kjo nuk duhet të shihet vetëm si një shpenzim, por duhet të shihet në këndvështrimin e një investimi, që vendi po bën për të tashmen dhe të ardhmen e tij. Unë nuk po them asgjë të re, por nuk duhet të harrojmë se fëmijët e sotëm janë pikërisht ata, të cilët, pas 30 apo 40 vjetësh, do të jenë këtu duke ju zëvendësuar juve dhe këdo tjetër, si dhe do të jenë pikërisht personat që do ta drejtojnë këtë shtet.

Unë jam i bindur se diskutimi i ditës së sotme do të përmbushë pjesën e raportit. Unë besoj se ne do të kontribuojmë në këtë forum, me aq mundësi sa kemi, për të përmirësuar situatën e fëmijëve në Shqipëri.

Unë dua t'ju falënderoj sërish në emër të UNICEF-it, në emër të të gjithë të rinjve dhe fëmijëve shqiptarë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Bernard!

Para se të kaloj te prezantimi i raportit të pestë periodik, dua të falënderoj deputetët e rinj për interesimin e tyre për të marrë pjesë në grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, pasi ky është takimi i parë që ata marrin pjesë. Sigurisht, grupi “Miqtë e fëmijëve” është i hapur dhe prania juaj sot, në këtë mbledhje të parë tuajën, është një gjë shumë pozitive. Gjithashtu, dua t'ju rikujtoj se sot po diskutojmë raportin e pestë që ka përgatitur Shqipëria, sepse katër raportet e tjera janë raportuar në vitet e kaluara.

Atëherë, pa humbur kohë, dua t'ia jap fjalën zëvendësministres për Europën dhe Punët e Jashtme, zonjës Dralo, për të prezantuar zbatimin e detyrave të deritanishme.

Fjala për ju, zonja Dralo.

Artemis Dralo – Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja Ministre,

Të nderuar përfaqësues të UNICEF-it,

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni të shpreh kënaqësinë që jam sot në këtë dëgjesë, si zëvendësministre për Europën dhe Punët e Jashtme.

Pa hezitim dua të shpreh se takimi i sotëm është, në fakt, një nga takimet më të rëndësishme vitet e fundit, në kuadër të monitorimit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka qenë në rolin koordinues për garantimin e raportit periodik të pestë, si dhe të gjashtë për Komitetin e të Drejtave të Fëmijëve, i cili do të paraqitet sot para jush.

Më lethoni të falënderoj për këtë proces të gjatë të gjithë anëtarët e grupit ndërministror të ngritur në mbështetje të urdhrin të Kryeministrit që prej vitit 2014, të cilët kanë qenë shumë

aktivë në pjesëmarrje për shqyrtimin e raportit në kuadër të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut! Gjithashtu, më lejoni të falënderoj Ministrinë e Shëndetësie dhe Mbrojtjes Sociale për mbështetjen teknike, si dhe juristët në Shqipëri, si bashkëpunëtorët më aktivë dhe të pandarë të këtij procesi, në ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve për hartimin e raportit sipas standardeve të komitetit.

Në fjalën time shkurtimisht do të doja të adresoja tri elemente kryesore: procesin e hartimit të raportit; përmbajtjen e raportit dhe hapat e mëtejshëm.

Së pari, afati i dorëzimit të raportit është tejkaluar me të paktën një vit. Kjo ka ndodhur, sepse procesi i hartimit rezultoi i gjatë. Ai ka nisur që në vitin 2017 dhe ka përfshirë një sërë institucionesh shtetërore në nivel qendror dhe lokal.

Dua të ndaj me ju disa nga sfidat që ne kemi hasur gjatë këtij procesi. Profesionistët e përfshirë në raportim nuk kanë pasur informacionin e mjaftueshëm për konventën, si dhe për vëzhgimin përmbledhës të komitetit. Mënyra e raportimit të institucioneve nuk përputhet me kërkesat specifike të raportimit. Kjo u diktua nga komiteti dhe si pasojë çoi në krijimin e një sërë hapash të përsëritur si të mbledhjes, të analizimit, ashtu edhe të vlefshmërisë së informacionit.

Gjithashtu, raportimi i bashkive rezultoi shumë i vështirë. Vetëm 6 nga 61 bashki plotësuan pyetësoin, edhe pse të gjitha përpjekjet u bënë (*mungesë incizimi*) ... e vetëqeverisjes vendore, në maksimumin e vet.

Pavarësisht sa më lart, raporti është përfunduar dhe përfshin arritjet dhe sfidat për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe të dy protokolleve opsionale të saj.

Aktualisht jemi në procesin e marrjes së mendimeve nga institucionet e përfshira, me qëllim paraqitjen për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Dorëzimi i raportit pranë sekretariatit të komitetit pritet të ndodhë brenda muajit të ardhshëm.

Raporti i referohet përmbushjes së vëzhgimeve përmbledhëse të komitetit drejtuar shtetit shqiptar që në vitin 2012. Kjo ka qenë një zgjidhje e qëllimshme nga grupi ndërministror i punës për të qenë më të drejtpërdrejtë dhe më transparentë.

Me bindje të plotë mund të them se raporti përmban informacionin më të pastër statistikor për fëmijët, krahasuar me çdo raport të kësaj natyre të publikuar më parë. Për herë të parë janë përfshirë edhe mendimet e fëmijëve, si një shtojcë e krahasueshme mes raportimit institucional dhe perceptimeve të atyre, për të cilët është shkruar raporti. Duke pasur parasysh se

raporti do të merret në shqyrtim nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve 1 deri në 2 vjet pas paraqitjes së tij, do të ftoja të gjithë aktorët ta konsiderojnë këtë hapësirë kohore për të përshpejtuar përpjekjet në zbatimin e vëzhgimeve përmbyllëse më pak të adresuara.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme nuk do ta ndërpresë punën e saj në monitorimin e zbatimit të konventës si dhe të protokolleve opsionale, brenda platformës për të drejtat e njeriut dhe për monitorimin e instrumenteve ndërkombëtare, e cila është publikuar në faqen e *web*-it të ministrisë.

Për këtë vit kemi shtuar modulën e konventës për të drejtat e fëmijës. Gjithashtu, synojmë të parashtrijmë 10 fusha veprimi me prioritet, për të cilat do të kërkohet informacion në fund të çdo viti, në dy vjetët e ardhshëm, me statusin e zbatimit.

Më pas kjo platformë do të pasurohet me vëzhgimet e reja përmbledhëse të komitetit, pas shqyrtimit dhe raportit që do të paraqesim.

Fushat tashmë janë identifikuar, duke krahasuar vëzhgimet përmbledhëse të komitetit me raportin, për të kuptuar se cilat prej tyre janë më pak të realizuara.

Deri më tani janë identifikuar këto fusha: buxhetimi për fëmijët, si prioritet; sistemet e të dhënave për fëmijët; parandalimi dhe mbrojtja nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit; arsimit cilësor gjithëpërfshirës, përfshirë këtu edhe atë parashkollor; shëndeti i adoleshentëve; sistemi i mbrojtjes sociale për familjet me fëmijë; kujdesi alternativ për fëmijët; drejtësia për të miturit; (*mungesë incizimi*) ... si dhe fëmijët rom.

Për ta realizuar sa më efektivisht këtë, ne do të mbështetemi në ndihmën teknike të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, të UNICEF-it, si dhe në rolin konsultativ të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

Ne mirëpresim çdo lloj rekomandimi që do të dalë nga ky takim, për të përmirësuar më tej procesin dhe monitorimin e raportit në vijim.

Duke përfunduar këtë fjalim hyrës, shpreh se objektivi në vetvete nuk mbetet thjesht monitorimi apo raportimi, por kryesisht angazhimi në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo konventë.

Ju uroj punë të mbarë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Fjalën ia kaloj zonjës ministre të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ogerta, fjala për ju.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Avokat i Popullit,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve partnere dhe shoqërisë civile,

Si ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por edhe si kryetare e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, shpreh mirënjohjen për organizimin e këtij aktiviteti.

Unë besoj se Grupi Parlamentar “Miq të Fëmijëve” po kryen një punë, e cila na ngarkon edhe ne si institucion përgjegjës me përgjegjësi të shtuara në raport me ecurinë e të gjithë hapave, rekomandimeve dhe vërejtjeve, të cilat janë për t’u zbatuar nga institucionet, për sa i përket mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve.

Raporti i 5-të periodik për zbatimin e konventës drejtuar Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve pasqyron gjerësisht gjithë veprimtarinë dhe punën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucioneve të saj të varësisë, por edhe institucioneve të tjera në kuadër të Konventës të të Drejtave të Fëmijëve, duke evidentuar atë që tha edhe Kryetari i Kuvendit, jo vetëm arritjet, por edhe problematikat, vështirësitë dhe sfidat që ne kemi përpara.

Në fillim të fjalës sime vlen të theksoj bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe faktorët që përfshihen në këtë fushë veprimi për përgatitjen e këtij raporti, por edhe asistencën teknike.

Dua të falënderoj UNICEF-in për konsultimet konstruktive dhe shoqërinë civile, e cila mbetet partneri ynë kryesor më aktiv në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Përtej informacionit që të gjithë e keni dhe që gjendet në raport, dëshiroj të përmend dhe të adresoj në mënyrë specifike komentet, vërejtjet dhe rekomandimet përmbyllëse të komitetit drejtuar shtetit shqiptar dhe ato që ne kemi realizuar në këto vite në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Për sa i përket legjislacionit, dua të ndalem pasi çdo gjë fillon nga zbatimi i mirë i ligjit. Por ligjet që nuk janë të kompletuara me akte nënligjore bëhen të vështira për t’u aplikuar. Ky nuk është rasti i ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” të vitit 2017, sepse ne jemi duke

punuar intesivisht dhe ligji është plotësuar me 18 akte nënligjore, duke përmbushur standardet edhe në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Kjo kornizë ligjore përbën një reformim si në aspektin e përcaktimit të roleve dhe përgjegjësive për sektorin shumë sektorial në funksion të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, neglizhenca, shfrytëzimi, duke përfshirë këtu edhe përgjegjësitë e pushtetit lokal në veçanti. Ligji përmban një përkufizim të qartë të termit “fëmijë” dhe institucionalizon zbatimin e interesit më të lartë të fëmijëve. Në përputhje edhe me autoritetin e caktuar nga ky ligj, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vijon ta fokusojë punën e saj në monitorimin e zbatimit të ligjit. Ajo që mbetet për t’u adresuar nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor është alokimi i burimeve njerëzore dhe financiare për përmbushjen e përgjegjësive të përcaktuara nga ky ligj.

Gjithashtu, ligji për shërbimet e kujdesit social në Republikën e Shqipërisë tashmë ka rregulluar shërbimet e kujdesit shoqëror edhe për fëmijët në nevojë për t’i mbështetur me shërbime, duke nxitur mirëqenien dhe përfshirjen sociale të personave në nevojë dhe të familjeve të tyre në kuadër të të gjitha shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Dua të jap disa të dhëna, të cilat nuk janë thjesht shifra, por janë përpjekje e drejtpërdrejtë e mbështetjes së të gjitha strukturave tona të shërbimeve sociale territoriale, rezidenciale apo ditore, në funksion të mbështetjes së grupeve në nevojë, të fëmijëve të cilët marrin shërbime në qendrat tona të përkujdesit në të gjithë Shqipërinë. Në qendrat rezidenciale dhe në ato ditore në të gjithë Shqipërinë sot marrin shërbimin 651 fëmijë, nga të cilët 77 fëmijë në qendrat e zhvillimi, 245 fëmijë në shtëpi/familjet rezidenciale apo ditore, 329 fëmijë në Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, në Qendrën Kombëtare të Viktimave të Trafikimit, Qendrën Kombëtare të Emergjencës për Romët dhe qendrat që mbulohen nga organizatat jofitimprurëse.

Dua të theksoj se qeveria shqiptare, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbështet jo vetëm shërbimet rezidenciale, të cilat janë funksione dhe struktura të saj, por edhe më shumë se 19 shërbime mbi bazë qarqesh. Ne do të vijojmë t’i mbështesim strukturat e shërbimeve sociale në territor nëpërmjet instrumentit të fundit që kemi ndërtuar, që është fondi social. Fondi social, si një mekanizëm i ri financimi, do të bëjë të mundur që pushteti lokal të marrë më shumë përgjegjësi në funksion të ngritjes sociale në territor për grupet në nevojë, kryesisht për fëmijët, të cilët kanë shumë nevojë për shërbime konkrete, në qendra komunitare, në qendra sociale, pa dyshim edhe rezidenciale për ato kategori, të cilat nuk janë të strukturuar

në bashki apo për të cilat pushteti lokal duhet të marrë më shumë përgjegjësi. Fondi në dispozicion nga buxheti i shtetit në programin buxhetor të mbrojtjes sociale për vitin 2019 është 150 milionë lekë në funksion të mbështetjes së shërbimeve sociale. Ne parashikojmë që ky buxhet të rritet çdo vit, duke vlerësuar këtu edhe kontributin që vetë bashkitë do të japin në kuadër të planeve sociale që pritet të miratojnë.

Së dyti, është adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë rekomandimi për planin e veprimit të fëmijëve, që ishte në fuqi deri në vitin 2015. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndërmori procesin konsultativ për hartimin e Axhendës Kombëtare të Fëmijëve 2017-2020, tashmë në proces zbatimi, duke u bazuar në vlerësimin e planit të mëparshëm, për më tepër duke e transformuar atë në një platformë gjithëpërfshirëse të masave në përputhje me fushat e konventës për të drejtat e fëmijëve. Aktualisht në mënyrë po aq rigorozë dhe transparente ministria ka drejtuar procesin e monitorimit afatmesëm të zbatimit të axhendës, me qëllim që të vlerësojë realizimin dhe përkushtimin e çdo institucioni përgjegjës, duke përfshirë edhe buxhetet e alokuara. Raporti, që do të shqyrtohet dhe do të miratohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Kombëtar të Fëmijëve, do të jetë i plotë duke nxjerrë të gjitha çështjet, sfidat dhe problematikat duke i adresuar tek institucionet përgjegjëse, në mënyrë që masat të jenë të menjëhershme dhe të mos kenë mundësi të shtyhen në kalenda. Ne jemi shumë të vendosur që çdo raport, i cili realizohet në funksion të monitorimit të strategjisë dhe planit të veprimit, të mundet të vlerësohet në kohë për t'ua dhënë të gjitha institucioneve përkatëse.

Rekomandimi i komitetit për fuqizimin e rolit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve është adresuar jo vetëm nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, por edhe rritjes së buxhetit të alokuar gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, ne jemi duke punuar për një riorganizim të strukturës së re organizative të Agjencisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, në mënyrë që jo vetëm ta pasurojmë me burimet e nevojshme dhe profesionale për të përmbushur detyrimet, por edhe për të ngritur dhe për të vënë në funksion skuadrat e terrenit. Aktualisht kemi 235 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, duke zbatuar kështu standardin ligjor: 1 punonjës për 3000 fëmijë në nivel vendor. Ndërkohë, janë ngritur dhe janë funksionale njësitë e mbrojtjes së fëmijëve për 61 bashki. Është në proces miratimi vendimi i qeverisë, që lidhet drejtpërsëdrejti me kriteret e punësimit të punonjësve në strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel qendror dhe vendor. Ministria, në veçanti Agjencia Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve, po përkushtohet për të rritur kapacitetet e profesionistëve në zbatimin e ligjit. Për këtë qëllim, së bashku me partnerët tanë

UNICEF-in, Save the Children dhe World Vision në bashkëpunim edhe me ASP-ën kemi filluar punën për akreditimin e programeve të kurrikulave për të gjithë punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve. Shumë shpejt do të firmosim memorandumit me ASP-ën për këtë qëllim.

Së katërti, një sërë rekomandimesh të komitetit lidhen ngushtësisht edhe me adresimin e dhunës ndaj fëmijëve. Në këtë kuadër, për herë të parë Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve i dedikon dy objektiva me masa të detajuara, të cilat adresojnë të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve. Në mbështetje të axhendës janë hartuar dhe janë në proces konsultimi plani për sigurinë *online* të fëmijëve dhe plani për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe shfrytëzimi ekonomik. Së fundi, qeveria ka miratuar procedurat për identifikimin, dhënien e ndihmës së menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, duke përfshirë fëmijët në situatë rruge, si dhe është në procedurë miratimi vendimi i Këshillit të Ministrave për sigurinë *online* të fëmijëve.

Gjatë vitit 2018, edhe me asistencën e OSBE-së, Agjencia e Mbrojtjes së Fëmijëve ka identifikuar 349 të fëmijëve në situatë rruge dhe shfrytëzimi ekonomik, 286 prej tyre janë në ndjekje të vazhdueshme nga strukturat përgjegjëse. Gjatë trajtimit të rasteve 12 prindër janë vlerësuar për procedim penal.

Dëshiroj t'ju informoj, gjithashtu, se me ndryshimet më të fundit në ligjin për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare janë sjellë një sërë përmirësimesh të ndjeshme lidhur edhe me mbrojtjen e fëmijëve, si në situatën kur ata janë viktimat të dhunës në familje, ashtu edhe në rastin kur janë dëshmitarë të një situatë dhune. Përfshirja e kujdestarit të të miturit në rrethin e anëtareve të familjes siguron tashmë një mbrojtje më të madhe të fëmijëve nën kujdestari.

Gjatë vitit 2018 janë trajtuar 90 raste të viktimave të dhunës në familje në marrëdhëniet familjare nga strehëza publike në Kamëz, nga të cilat 36 gra dhe 56 fëmijë kanë marrë shërbim social, psikologjik, mbështetje ligjore, shërbime shëndetësore dhe arsimim. Ndërkohë që janë integruar në punësim, strehim dhe arsim nga 1 janari 2018 deri në 28 mars 2019, 19 gra së bashku me 29 fëmijë.

Për herë të parë në Shqipëri është hapur një qendër emergjence për viktimat e dhunës seksuale, qendra “Lilium”, e cila, përveçse trajton gratë, trajton edhe fëmijët viktimat të dhunës seksuale. Në këtë qendër ofrohet ndihma e parë sociale, shëndetësore, psikologjike, mjetet ligjore dhe gjithçka që nevojitet sipas standardeve të miratuara për funksionimin e kësaj qendre në

ndihmë të viktimave të dhunës seksuale. Me ndihmën e PNUD-it dhe falë një bashkëpunimi me qeverinë koreane personeli vijon të trajnohet.

Siç shprehet edhe në rekomandimet e Komitetit, zbatimi i ligjit, planeve të veprimit për të ndërtuar një (*ndërprerje incizimi*) shumëdimensional të parandalimit dhe integritit të fëmijëve, viktimave të dhunës, si dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna e abuzimi seksual, siguria e fëmijëve online dhe parandalimi i shfrytëzimit ekonomik të tyre do të ngelen synim parësor i ministrisë.

Gjithashtu, sistemi i informacionit për menaxhimin e rastit do të ndërthuret me sistemin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, atë të aftësisë së kufizuar dhe ndihmës ekonomike si programe të mbrojtjes sociale, të cilat orientojnë shërbimet drejt mbrojtjes së fëmijëve.

Numri i fëmijëve që përfitojnë nga skemat tona të mbrojtjes, duke përfshirë këtu skemën e ndihmës ekonomike, është 78 535 fëmijë dhe 14 992 fëmijë me aftësi ndryshe janë mbështetur me pagesa kesh, duke përfshirë moshën 0-18 vjeç.

Së pesti, pritshmëritë e komitetit lidhur me fëmijët pa kujdes prindëror janë plotësisht të përfshira në planin tonë të deinstitutionalizimit, zbatimi i të cilit tashmë ka filluar me prioritet për të parë rezultatet deri në kthimin e fëmijëve në familjet biologjike, në familjet kujdestare dhe duke parë rast pas rasti interesin më të lartë të fëmijëve.

Nisma “Fëmijët të parët”, ndërmarrë në vitin 2018, në kuadër të deinstitutionalizimit të fëmijëve, është në proces. Janë 5 skuadra terreni që po punojnë, 20 profesionistë të fushës dhe ekspertë të kualifikuar në bashkëpunim me organizatat partnere, të cilat janë duke vlerësuar fëmijët në institucione.

Për herë të parë janë parashikuar masa për rehabilitimin prindëror, duke synuar kthimin e fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ në gjirin e familjes përmes fuqizimit dhe mbështetjes së familjes ose ndërhyrjes për të përmirësuar marrëdhëniet në familje nëse fëmija jeton ende me ta.

Gjithsesi, zbatimi efektiv i planit të deinstitutionalizimit do të kërkojë ndryshime drastike edhe për sa i përket përmirësimit të kapaciteteve, praktikave të institucioneve të përfshira, por për më tepër realizimit të suksesshëm të objektivave, që kërkojnë vullnet pozitiv dhe burime të dedikuara financiare edhe nga pushteti lokal.

Në fushën e kujdesit shëndetësor dua të ndalem në dy momente.

Së pari, në të dhënat e studimit demografik dhe shëndetësor, i cili tregon se nga viti 2009 deri në vitin 2018 ka një përmirësim të dukshëm të indikatorëve të shëndetit të fëmijëve, më konkretisht, kanë përmirësim të dukshëm të gjendjes nutricionalë të fëmijëve nga mosha 0-5 vjeç, aktualisht vetëm 11% e fëmijëve janë të shkurtër për moshën apo *stuning*, që është indikator, krahasuar me 19% që raportohet në studimin demografik dhe shëndetësor të vitit 2009, vetëm 2% e fëmijëve janë të dobët për gjatësinë e tyre, krahasuar me 9% që raportohen në vitin 2009. Gjithashtu, ka përmirësime në numrin e fëmijëve që janë mbi peshë dhe ata nën peshë. Fëmijët e moshës pediatrike dhe ata të moshës 5-18 vjeç përfitojnë të gjitha shërbimet parandaluese apo të kujdesit shëndetësor në bazë të paketës bazë të përfitimeve në kujdesin shëndetësor parësor dhe spitalor.

Vaksinimi është pjesë e paketës së kujdesit shëndetësor parësor, i cili ofrohet falas për të gjithë në çdo qendër shëndetësore dhe ambulancë për moshat 0-18 vjeç, me qëllim që të ketë një mbulesë vaksinale më të lartë.

Për sa i përket mesatares së mbulesës vaksinore, varion nga 95 në 99% në shkallë vendi me një mesatare 98% , duke treguar për një cilësi të vlefshme të këtij shërbimi, atë të ofrimit të aksesit për çdo fëmijë, pavarësisht vendit ku banon apo gjendjes sociale ekonomike, duke e bërë atë një tregues model të barazisë në ofrimin e shërbimit shëndetësor.

Po ashtu kujdesi i nënës dhe fëmijës është në fokusin tonë, jo vetëm për politikat e reja që ne kemi nisur, siç është politika mbështetëse nëpërmjet çekut të bebes, tashmë një politikë e filluar në këtë vit, ku nga janari deri sot janë më shumë se 4 mijë fëmijë, të cilët kanë përfituar nga mbështetja direkte e shpërblimit financiar për fëmijën e parë, të dytë, të tretë e kështu me radhë. Kjo është një politikë e realizuar në sajë të reformave të qeverisë dhe ndikon direkt në zhvillimin dhe rritjen e fëmijëve, e cila i vendos të gjithë fëmijët në një stad të barabartë.

Më lejoni të ndaj edhe prioritetet e tjera të ministrisë për këtë vit dhe vitin e ardhshëm, të cilat kanë lidhje edhe me rekomandimet e Komitetit, që është përmirësimi i qasjes së kujdesit shëndetësor, duke integruar edhe elementet e mbrojtjes së fëmijëve dhe gjithashtu shëndetin e adoleshentëve, përfshirë elemente të shëndetit mendor, edukimit seksual dhe riprodhues, ndalimit të substancave narkotike dhe mbi të gjitha ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve.

Për sa u përket disa çështjeve me rëndësi të veçantë për ne, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuar dhe fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian mbeten prioritet të punës së ministrisë, jo vetëm sa u përket planifikimit dhe monitorimit të masave për këtë kategori, por edhe përfshirjes

dhe integritit në planet kombëtare sa i përket integritit të romëve dhe egjiptianëve, të cilët, përveç planeve nacionale, tashmë janë kthyer edhe në elementë të planeve lokale.

Reforma në sistemin e aftësisë së kufizuar është duke vijuar me asistencën e Bankës Botërore. Së shpejti dokumenti i politikave të aftësisë së kufizuar do të miratohet nga qeveria dhe është një reformë, e cila ka në fokus trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar sipas një vlerësimi të ri ndërkombëtar, që është vlerësim biopsikosocial.

Më lejoni edhe një herë t'ju them se përkushtimi ynë do të jetë maksimal drejtuar komitetit dhe në veçanti rekomandimeve, që ende nuk janë realizuar plotësisht, të cilat do të shërbejnë pa dyshim si një pikënisje e angazhimeve tona ndërsektoriale.

Shumë faleminderit për vëmendjen!

Gramoz Ruçi – Faleminderit ju, zonja Ministre, për prezantimin!

Tani vazhdojmë me pyetjet, mendimet dhe sugjerimet që kanë të pranishmit.

Enver Roshi – Zoti Kryetar, faleminderit!

Unë e quaj veten të privilegjuar që jam pjesë e grupit “Miq të fëmijëve”, njëkohësisht profesioni im si mjek, ku kam punuar në zonat më të thella të Shqipërisë, (*Nuk kuptohet*), por, njëkohësisht, edhe profesioni që kam, shëndeti publik, duke qenë edhe pedagog në universitet, më jep privilegjin e madh që të ndaj me ju disa mendime rreth raportit, të cilin e vlerësoj si arritje.

Dua të përmend një thënie tuajën në hapjen e këtij takimi: “Ky raport na jep shumë informacion, por nuk na jep gjërat, që nuk janë bërë”. Natyrisht, arritjet janë të dukshme, problemi i fëmijëve jo vetëm Shqipëri (*shkëputje e regjistrimit*) e ardhmërisë së kombit, të sigurisë, të stabilitetit social–ekonomik dhe gjithçka. Po të kemi parasysh faktin se në vitet '90 Shqipëria kishte 90 mijë lindje në vit dhe vdekshmëria foshnjore i kalonte 30-40 për mijë, vetëm në zonën e Kukësit ishte 70 për mijë, kurse në disa zona ishte 200 për mijë. Tashmë trendi i vdekshmërisë foshnjore kap shifrën 1–shifrore, pra është 8 ose 9, dhe kjo është një arritje e madhe e gjithë këtij tranzicioni, natyrisht edhe qeverive që i kanë dhënë një fokus veçantë mirërritjes së fëmijëve, lindjeve dhe kujdesit antenatal, natal dhe posnatal.

Natyrisht, etja për t'u shërbyer gjithmonë fëmijëve është e pangopur jo vetëm tani, por kjo është një gropë që kërkon vazhdimisht të ardhura, kërkon financa dhe kërkon përkushtim. Kështu që, gjithmonë, do të jemi në kërkim të më së mirës. Kjo ka të bëjë edhe me kërkesat e shoqërisë, ku ne punojmë dhe sigurojmë të ardhmen.

Ajo që duhet thënë në këtë raport, është se trendi i indikatorëve, i cila ka të bëjë me vrasjet, është dukshëm në rënie dhe kjo tregon se është punuar në këtë drejtim.

Ashtu siç e përmendi edhe zonja ministre, po fillojmë problemet obezitetit. Pra, në raportin e parë ne kishim një ambiguitet, ku 20% e fëmijëve 0-5 vjeç ishin nën peshë dhe 20% e fëmijëve ishin mbi peshë. Kjo tregonte se kishte diferenca të mëdha midis zonave rurale dhe zonave urbane. Kjo tregon edhe diferencën në zhvillim, në urbanizim të pjesës që vjen nga fshatrat. Ajo që dua të them është, se kjo kërkon një qasje multisektoriale dhe shumë profesionale. Pra, nuk duhet vetëm fokusi i qeverisë, por duhet edhe fokusi i shumë institucioneve që janë në Shqipëri, si: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, por njëkohësisht edhe të gjithë shoqërisë, si media në veçanti.

Përgjithësisht ne mbetemi te pjesa edukimit. Duhet të përqendrohemi fuqishëm te pjesa e edukimit të fëmijëve që në moshën parashkollore dhe shkollore. Duhet të krijojmë modelin e mësuesit edukator, që fëmija ta përjetojë mësuesin si prind. Për shembull, sot kjo gjë po na rrëshqet. Dikur fëmijët qanin për mësuesit, kurse sot fëmijët e parashkolloreve fillojnë të kenë emocione të tjera ndaj mësuesit. Kjo kërkon një qasje shpirtërore, edukative, pra një lidhje të fuqishme midis familjes dhe shkollës.

Po të shikoni dhuna në familje, ishte e treta për nga numri, në qoftë se do ta rendisim. Pra, shikojmë që familjet shqiptare janë në një proces të vështirë akomodimi me situatën, për të cilën ne kemi tranzicion të gjatë. Konflikti social që ishte brenda, tashmë ka hyrë në familje. Besoj se këtu duhet të eksplorojmë dhe të shikojmë se cilat janë shkaqet e kësaj.

Përveç kësaj, dua të them se sjelljet jo të shëndetshme, si duhanpirja, alkooli dhe droga, janë fenomene të çdo shoqërie, por edhe në vendin tonë këto fenomene janë të kapshme. Ajo që më bëri përshtypje në raport ishte fenomeni i duhanpirjes në shkollën private ishte më i lartë se në shkollat publike. Kjo duhet parë, pra cilat janë kontingjentet që shkojnë në shkollat private apo të tjera. Pra, fokusi duhet të jetë edhe tek arsimit privat në Shqipëri.

Gjithsesi, këtu ka shumë gjëra për të folur, veç atyre që unë do të thosha se janë risi për t'u përmendur dhe për t'u lavdëruar nga qeveria, por gjithsesi thashë se ne nuk duhet të kënaqemi me arritjet tona. Gjithmonë kemi të bëjmë me një brez, i cili duhet të sigurojë ardhmërinë e vendit tonë dhe të kombit tonë.

Dua ta inkurajoj fuqishëm qeverinë dhe parlamentin, se ka disa nisma të filluara edhe më parë në harkun kohor të këtyre viteve për miratimin e ligjit “Për jodizimin e kripës”. Kjo

është një arritje e madhe, sepse para demokracisë, prevalenca e fëmijëve me strum ishte në masën 60%-70% në zonat ku unë punoja, mbas studimeve që kam bërë. Po të marrim parasysh këtë tregues, atëherë ne nuk mund t'i lëmë fëmijët që të vuajnë pasojat influencës jodike që kanë të bëjnë me intelektin dhe rritjen e tyre.

Njëkohësisht, ka qenë edhe një tjetër ligj i përgatitur, por nuk ka ardhur është nga qeverisjet e mëparshme, që kishte të bënte me prevalencën e anemisë së rritur te fëmijët dhe gratë te popullata rurale, e cila kishte të bënte me fortifikimit e miellit. Ka 80 mijë vende në botë, që bëjnë fortifikimin e miellit për vitaminën, për hekurin dhe shtesat e tjera, që janë të nevojshme që të merren me ushqimin. Pra, janë disa nisma, të cilat ne mund t'i bëjmë.

Sigurisht, ky raport na meson shumë gjëra. Ajo që dua të them, meqenëse ministrja përmendi krijimin te disa strukturave këtu. Ne kemi krijuar një institucion, një degë në Fakultetin e Mjekësisë, që është "Specialistë të shëndetit publik", janë studentë, të cilët u dedikojnë jetën vetëm shëndetit.

Para disa vjetësh unë kam qenë dekan, por e mbylla fakultetin, sepse me numrin që erdhën studentët tregu i punës u goditë keq dhe me kurajë e mbyllëm fakultetin për të sistemuar këta që mbaruan. Tani ne kemi një degë, e cila ka 20 veta në vit. Profesionistë të tjerë të afërt në shëndetin publik janë jo të shumtë. Pra, ministria të shikojë mundësinë që të eksplorojë dhe të caktojë këta persona, që i dedikohen veçanërisht shëndetit, pra fëmijëve, grave dhe adoleshentëve. Pra, me mbarimin e kësaj dege këta i kushtojnë jetën këtij institucioni dhe do të isha i lumtur, në qoftë se kjo do të ishte edhe për ju një arritje që t'i përfshini këta në emërimet si profesionistë, pra t'i gjeni vendin se ku mund të përfshihen këta. Natyrshëm se këtu ka gjithmonë vend për të folur dhe nuk do të kënaqemi me këtë arritje.

E thashë, unë si mjek, shikoj shumë arritje, dikur ne vdekshmërinë foshnjore e kishim të lartë për shkak të kushteve në lindje. Për shembull, sot shikoj se infeksionet respiratore janë në 1,14 për një mijë vdekje si shkak kryesor. Pra, tregon se ka probleme midis periudhës antenatale, natale dhe posnatale, të cilat rregullohen në organizimin shëndetësor, pra me pak organizim rregullohen. Nuk duhet të harrojmë se shkak kryesor i vdekjeve sot te fëmijët janë anomalit kongenitale të papërballueshme për jetën. Kjo tregon se ka sjellë një përmirësim të dukshëm në drejtim të vdekshmërisë jo vetëm kaq, por edhe vdekshmëria amtare shkon me të bashkë, që është në ulje të ndjeshme.

Edhe një herë, e përsëris, ndihem tejte i privilegjuar dhe i vlerësuar që bëj pjesë në grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, si dhe do të jem një aleat gjithnjë i fëmijëve, si profesionist, por edhe si mbrojtës dhe si avokat i tyre. Madje do ta nxis gjithnjë qeverinë, deputetët dhe kolegët e tjerë për të qenë të gjithë së bashku në një organizëm të veçantë për t’u shërbyer fëmijëve tanë.

Faleminderit edhe një herë për gjithçka!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, profesor!

Kush tjetër e do fjalën?

Altin Hazizaj – Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Altin Hazizaj dhe vij nga organizata “CRCA – Shqipëri, Qendra për të Drejtat e Fëmijëve”.

Në fakt, dua t’u uroj mirëseardhjen deputetëve të rinj, së pari, si organizata, që ka nxitur krijimin e këtij grupi parlamentar. Për ne është vërtet pozitive dhe përbën progres fakti që Kuvendi tashmë ka mundësi për të kërkuar, do të thosha, llogari nga qeveria.

Përsëri në këtë kuadër, pa diskutim, dua të përshëndes të gjitha përpjekjet e qeverisë, Ministrisë së Jashtme dhe ministrive të tjera për sa i përket përgatitjes së raportit zyrtar, që, pavarësisht se nuk është zyrtar, pra nuk ia ka vënë vulën Këshilli i Ministrave, po e quajmë të tillë.

Kam disa shqetësime, që, në fakt, dua t’i ndaj me ju.

Do të ishte mirë që grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” të kërkojë llogari pse raporti zyrtar i qeverisë është përgatitur dy vjet me vonesë dhe cili ka qenë faktori që ka ndikuar që për dy vjet Shqipëria nuk ka raportuar. Në fakt, e gjithë periudha e raportimit shtyhet me katër vjet. Raportimi ka qenë për në shtator të 2017-ës, nuk është raportuar, çka do të thotë se periudha më e mundshme, viti 2020 është i zënë tashmë, mbetet viti 2021. Në fakt, kjo tregon, të paktën në bindjen time, se fëmijët, pavarësisht dëshirës së mirë dhe punës së përbashkët, nuk kanë qenë prioritet i disa ministrive. Kështu që në këtë aspekt, pa diskutim, ka nevojë për shtim të llogaridhënies.

E dyta, unë mendoj se ndoshta do të duhej të kishte një angazhim më të mirë për të parë pse një pjesë e mirë e rekomandimeve të komitetit, pra rekomandimeve të kaluara, që i përkasin raportit nr. 4, nuk janë realizuar, nuk janë zbatuar, për të gjetur faktorët pengues të mosrealizimit të atyre rekomandimeve.

Shqetësimi i tretë që kam është fakti se çfarë qeveria shpreh si arritje, nuk është detyrimisht arritje për fëmijët. E them këtë, sepse ne sapo kemi përfunduar një raport për të drejtat e fëmijëve, ky është një raport i përbashkët në nivel kombëtar, që e kanë përgatitur të gjithë fëmijët në Shqipëri, është në bashkëpunim me qendrën CRCA. Nga ky raport rezulton, dhe ky fakt është për t'u shqetësuar, që vetëm 12% e fëmijëve mendojnë se të drejtat e tyre në Shqipëri respektohen, ndërkohë që 74% e fëmijëve thonë se të drejtat e tyre janë të respektuara në Shqipëri disi. Pra, një disnivel kaq i madh ndërmjet respektit ose *quasi-respektit*, atij që mund të quhet respekt i pjesshëm nga respekti i plotë, tregon që kemi një diferencë goxha të theksuar ndërmjet asaj që fëmijët mendojnë se është e drejtë, por nuk është realizuar, dhe çfarë mendojmë ne të rriturit. Në këtë mes të mosrealizimit e fus edhe veten, me thënë të drejtën.

Lidhur me sugjerimet që kam për sa i përket punës, për mua është pak shqetësues fakti që sot në raport nuk u përmend varfëria. Ministrja përmendi që janë pothuajse 74 mijë fëmijë përfitues të ndihmës ekonomike. Në fakt, nga të dhënat e INSTAT-it na rezulton që duhet të jenë mbi 150 mijë fëmijë. Kështu që, unë do të rekomandoja një rishikim ose një shikim më të mirë, sepse janë mbi 81 mijë familje që marrin ndihmë ekonomike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

INSTAT-i raporton 81 mijë familje, nga të cilat pjesa më e vogël, në mos gaboj, vetëm 4 mijë prej tyre, janë familje me një fëmijë, ndërkohë që pjesa tjetër, pra shumica e të gjitha familjeve janë me tre deri në pesë fëmijë. Kjo do të thotë se statistikisht është e pamundur të ketë 78 mijë fëmijë të varfër në Shqipëri me ndihmë ekonomike, pra numri duhet të jetë shumë më tepër i lartë.

Si çështje të fundit kam tre rekomandime kryesore.

E para, unë nuk mendoj se struktura monitoruese e raportimit për të drejtat e fëmijës, por edhe i gjithë raportimi i situatës së fëmijëve nuk duhet të varet nga Ministria e Jashtme, siç është, në fakt, procedura standarde. Për aq kohë sa Shqipëria e ka tashmë një strukturë të ngritur, sado, në fakt, janë dy të tilla (Komiteti Kombëtar për të Drejtat e Fëmijës, që drejtohet nga ministrja, dhe Agjencia Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës), do të thotë që mund ta vendosim të gjithë çështjen e raportimit periodik mbi baza të përvitshme, për aq kohë sa ka agjenci, të cilat, duan apo nuk duan, nuk i shmangen detyrimit ligjor për raportimin.

E dyta, unë mendoj që, bazuar te gjetjet e të gjitha rekomandimet e raportit, është tepër i nevojshëm rishikimi i Axhendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve. Ndoshta ky mund të jetë

një premtim, që mund ta marrim nga zonja ministre, meqenëse është prezente këtu, sepse, në fakt, ka ardhur koha që agjencia të përshtatet me realitetet e reja në iniciativat me fëmijët.

E treta, unë besoj se është një hap pozitiv. Ne sapo kemi filluar procedurën e përgatitjes së raportit alternativ. Kështu që në këtë aspekt është patjetër një ftesë e hapur për të gjithë shoqërinë civile që të bëhemi pjesë e këtij raporti, i cili, sigurisht, jep mendimin tonë, si shoqëri civile, të pavarur, përkundrejt atij të qeverisë që po bën raportin zyrtar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Po, zonja Dralo.

Artemis Dralo – Faleminderit shumë!

Për sa i përket pyetjes ose shqetësimit të parë, që ngritët për afatin e raportit, në fakt, e përmenda edhe në fjalën time, afati i raportit është tejkaluar me të paktën një vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Normalisht në rolin koordinues që ka pasur Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, sepse, në fakt, ju ngritët shqetësimin që nuk ka pse të jetë Ministria e Jashtme përgjegjëse, në, fakt, Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare, që varet nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, në procesin e saj të punës ka pjesën e raportimeve...

(Fjala e zëvendësministres ka herë pas here shkëputje.)

Raportimeve kryesore, të cilat nuk po i quaj kanale diplomatike, por si institucion shtetëror u përgjigjet ministria përkatëse, për të cilën ajo koordinon edhe të gjitha ministrinë e linjës, grupet ndërinstitucionale dhe partnerët për të cilët u fol.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, arsytet pse raporti u vonua ndoshta me një vit, prej vitit 2017, janë tre.

Së pari, na rezultoi që profesionistët e përfshirë në këtë raportim nuk dispononin informacionin e mjaftueshëm. Ndaj, për sa kohë ky raportim ishte shumë i rëndësishëm dhe është një raport, i cili nuk mund të shkojë as paraprakisht, as provizorisht, na u desh ta riinspektonim dhe ta rimerrim në konfirmim. Kjo ishte arsyeja e parë, ndërkohë që Konventa për Vëzhgimet Përmbledhëse të Komitetit e kishte shumë të qartë rekomandimin.

Një arsye tjetër, që e përmenda më parë, ishte mënyra e raportimit, pra praktika që u ndoq gjatë raportimit të të gjitha institucioneve dhe aktorëve që ishin mbledhur në këtë proces ishte diktuar nga...

(Shkëputje regjistrimi)

Absolutisht nga rekomandimet që na kishin ardhur. Kjo na detyroi që të ndërmerrnim një sërë hapash të tjera, duke përfshirë rimbledhjen e informacionit, analizimin e informacionit e deri në ... e informacionit. Në fakt, ka qenë një insistim i vazhdueshëm jo nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, por nga raportimi i bashkive. Nga 61 bashki që kemi, fatkeqësisht vetëm 6 bashki raportuan në pyetësorin që ne kishim kërkuar që të plotësohej. Kjo është bërë si pasojë e një kushti të vazhdueshëm të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, por edhe nga të gjithë aktorët e tjerë. Kështu që na u desh që të rimerrnim kohë.

Ju përmendët vitin 2020, por, në fakt, më lejoni t'ju bëj me dije se dorëzimi i raportit pranë sekretariatit të komitetit pritet të ndodh brenda muajit të ardhshëm.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni!

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Është kënaqësi që deputetët e rinj e nisin sot punën me një takim shumë të rëndësishëm me grupin e deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”. Po flasim për fëmijët, të ardhmen e vendit tonë, për ata që nesër do të ulen në karriget ku ne jemi sot. Është kënaqësi që raporti, të cilin ne e kemi parë aq sa kishim mundësi, ka një vlerësim shumë pozitiv. Dua të vlerësoj arsimimin e këtyre fëmijëve. Ka një rritje të pjesëmarrjes së tyre në shkolla, nga 91,8% që ka qenë në vitin 2013, në 99%. Sot në rrugët e Tiranës fëmijët që bënin atë punë që ne e dimë janë më pak në numër. Pra, është një vlerësim maksimal, por raporti duhet parë edhe me syrin kritik. Bashkitë janë më shumë përgjegjëse për t'u ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve. Ato duhet të kishin bërë më shumë programe që më pas ne si ligjvënës t'i mbështesim dhe të merrnim masa që e ardhmja e tyre të ishte më e sigurtë.

Kam kënaqësi që ne sot diskutojmë dhe do të mbështesim çdo nismë për t'u ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve, vendit tonë, Shqipërisë, që t'i minimizojmë dhe të kemi një brez të ardhshëm që të përballët kudo si vend europian. Normalisht duhet parë edhe një moment i rëndësishëm, sepse të gjithë e dimë që droga dhe prostitucioni janë në këmbë. Duhet të ketë programe të detajuara në mënyrë që ne të vijmë në ndihmë dhe ta shmangim edhe këtë fenomen që është prezent në shoqërinë tonë.

Mendoj se puna e bërë nga ky grup është shumë pozitive dhe në të ardhmen ne do të japim kontributin tonë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Po.

Ariana Pëllumbi – Përshëndetje të gjithëve!

Quhem Ariana Pëllumbi dhe jam përfaqësuese e Inspektimit të Shërbimit Shoqëror, pjesë e Inspektoratit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Ajo që doja të shtoja është një shqetësim që ka të bëjë me prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ne jemi aktori kryesor i reformës sociale dhe kjo pasqyrohet mjaft mirë në ligjin e ri të kujdesit shoqëror që është miratuar në muajin nëntor të vitit 2016.

Ka 2 vjet që aktet nënligjore për implementimin e këtij ligji, ku përfshihet ristrukturimi i të gjitha bashkive, forcimi i rolit të bashkive, si dhe forcimi i Inspektoratit të Shërbimit Shoqëror si një strukturë më vete në varësi të ministrit të fushës, nuk kanë dalë akoma.

Unë jam pjesë e Inspektoratit të Punës, një strukturë e vogël e shërbimit shoqëror, e pambështetur, që jemi në varësi të Ministrisë së Financave, por që raportojmë periodikisht në Ministrinë e Shëndetësisë. Pjesë shumë e rëndësishme në aktet nënligjore që duhen provuar është struktura e Inspektimit të Shërbimit Shoqëror, pasi është inspektimi ai që kontrollon të gjitha shërbimet dhe standardet e reja që do të dalin me aktet nënligjore. Forcimi i kësaj strukture ndoshta do të ndihmojë për të përcaktuar edhe shërbimet e reja komunitare, të cilat janë pasqyruar në ligjin e ri të shërbimit shoqëror. Do të doja që kjo të shtohej te prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë pasi ne raportojmë tek ajo ministri dhe jemi pjesë e reformës sociale.

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Do të jap unë një përgjigje për këtë çështje.

Bashkë po komunikojmë për herë të parë. Në parim unë jam dakord me shqetësimin që ka vonesa për daljen e akteve nënligjore dhe udhëzimeve të ndryshme, por sot mora vesh që administrata e shtetit tonë akoma nuk di kush bën çfarë. Ju po kërkoni atë që duhet të inicioni vet, në një kohë që duhet të jepni llogari pse nuk kanë dalë aktet normative, pse nuk i ke propozuar apo dërguar përfaqësuesit të dikasterit. Në qoftë se duhen miratuar me firmën e tij, le t'i miratojë, ose nëse duhen miratuar me VKM, le të shkojnë në Këshillin e Ministrave.

Makineria e shtetit të vërtetë nuk është ministri dhe as mbledhja e qeverisë, por administrata e shtetit, ku ju jeni drejtues. Gjëja e parë që duhet të bësh kur del një ligj nga parlamenti është të pyesësh se cila është detyra ime dhe çfarë duhet të bëj unë për këtë. Detyra e

parë janë aktet normative, të cilat duhet t'i inicioni ju e para bashkë me gjithë administratën tënde.

Po, zonja avokate.

Erinda Ballanca – Faleminderit!

Në fakt, puna për bërjen e këtij raporti dhe praktika për ta trajtuar fillimisht raportin si një draft-raport është një praktikë shumë e mirë, pasi ky është një nga të paktat raporte që diskutohen me publikun përpara sesa të dërgohen nga ana e qeverisë. Nuk ka ndodhur e njëjta gjë në raste të tjera dhe prandaj është një praktikë për t'u vlerësuar.

Në lidhje me raportimin, për të mos qenë përsëritës, nuk mund të mos e konsiderojmë një problem dhe duhen identifikuar personat përgjegjës se përse ky raportim po vjen me vonësë. Pra, nëse ne nuk do të mbajmë përgjegjësi apo nuk do të ngarkojmë personat me përgjegjësi administrative, të jeni të bindur që ky gabim do të ribëhet dhe do të vijmë përsëri në momentin tjetër të raportimit me të njëjtat problematika.

Unë e kuptoj që problemi kryesor janë kapacitetet njerëzore për përgatitjen e këtyre projekteve dhe për krijimin e strukturave që duhet të jenë në administratën tonë shtetërore apo lokale me një vëmendje të veçantë për këto lloj raportimesh. Unë e shikoj në institucionin tim si një problem thelbësor këtë gjë dhe e kam kërkuar për 2 vjet në Kuvend duke thënë se duhet krijuar një strukturë brenda secilës prej organeve që të ndërmerri një sërë hapash të tjera, duke përfshirë rimbledhjen e informacionit, analizimin e informacionit e deri në e informacionit. Në fakt, ka qenë një insistim i vazhdueshëm jo nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, por nga raportimi i bashkive. Nga 61 bashki që kemi, fatkeqësisht vetëm 6 bashki raportuan në pyetësorin që ne kishim kërkuar që të plotësohej. Kjo është bërë si pasojë e një kushti të vazhdueshëm të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, por edhe nga të gjithë aktorët e tjerë. Kështu që na u desh që të rimerrnim kohë.

Ju përmendët vitin 2020, por, në fakt, më lejoni t'ju bëj me dije se dorëzimi i raportit pranë sekretariatit të komitetit pritet të ndodh brenda muajit të ardhshëm.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni!

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti Kryetar!

Është kënaqësi që deputetët e rinj e nisin sot punën me një takim shumë të rëndësishëm me grupin e deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”. Po flasim për fëmijët, të ardhmen e vendit tonë, për

ata që nesër do të ulen në karriget ku ne jemi sot. Është kënaqësi që raporti, të cilin ne e kemi parë aq sa kishim mundësi, ka një vlerësim shumë pozitiv. Dua të vlerësoj arsimimin e këtyre fëmijëve. Ka një rritje të pjesëmarrjes së tyre në shkolla, nga 91,8% që ka qenë në vitin 2013, në 99%. Sot në rrugët e Tiranës fëmijët që bënin atë punë që ne e dimë janë më pak në numër. Pra, është një vlerësim maksimal, por raporti duhet parë edhe me syrin kritik. Bashkitë janë më shumë përgjegjëse për t'u ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve. Ato duhet të kishin bërë më shumë programe që më pas ne si ligjvënës t'i mbështesim dhe të merrnim masa që e ardhmja e tyre të ishte më e sigurtë.

Kam kënaqësi që ne sot diskutojmë dhe do të mbështesim çdo nismë për t'u ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve, vendit tonë, Shqipërisë, që t'i minimizojmë dhe të kemi një brez të ardhshëm që të përballët kudo si vend europian. Normalisht duhet parë edhe një moment i rëndësishëm, sepse të gjithë e dimë që droga dhe prostitucioni janë në këmbë. Duhet të ketë programe të detajuara në mënyrë që ne të vijmë në ndihmë dhe ta shmangim edhe këtë fenomen që është prezent në shoqërinë tonë.

Mendoj se puna e bërë nga ky grup është shumë pozitive dhe në të ardhmen ne do të japim kontributin tonë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Po.

Ariana Pëllumbi – Përshëndetje të gjithëve!

Quhem Ariana Pëllumbi dhe jam përfaqësuese e Inspektimit të Shërbimit Shoqëror, pjesë e Inspektoratit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Ajo që doja të shtoja është një shqetësim që ka të bëjë me prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ne jemi aktori kryesor i reformës sociale dhe kjo pasqyrohet mjaft mirë në ligjin e ri të kujdesit shoqëror që është miratuar në muajin nëntor të vitit 2016.

Ka 2 vjet që aktet nënligjore për implementimin e këtij ligji, ku përfshihet ristrukturimi i të gjitha bashkive, forcimi i rolit të bashkive, si dhe forcimi i Inspektoratit të Shërbimit Shoqëror si një strukturë më vete në varësi të ministrit të fushës, nuk kanë dalë akoma.

Unë jam pjesë e Inspektoratit të Punës, një strukturë e vogël e shërbimit shoqëror, e pambështetur, që jemi në varësi të Ministrisë së Financave, por që raportojmë periodikisht në Ministrinë e Shëndetësisë. Pjesë shumë e rëndësishme në aktet nënligjore që duhen provuar është

struktura e Inspektimit të Shërbimit Shoqëror, pasi është inspektimi ai që kontrollon të gjitha shërbimet dhe standardet e reja që do të dalin me aktet nënligjore. Forcimi i kësaj strukture ndoshta do të ndihmojë për të përcaktuar edhe shërbimet e reja komunitare, të cilat janë pasqyruar në ligjin e ri të shërbimit shoqëror. Do të doja që kjo të shtohet te prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë pasi ne raportojmë tek ajo ministri dhe jemi pjesë e reformës sociale.

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Do të jap unë një përgjigje për këtë çështje.

Bashkë po komunikojmë për herë të parë. Në parim unë jam dakord me shqetësimin që ka vonesa për daljen e akteve nënligjore dhe udhëzimeve të ndryshme, por sot mora vesh që administrata e shtetit tonë akoma nuk di kush bën çfarë. Ju po kërkonit atë që duhet të inicioni vet, në një kohë që duhet të jepni llogari pse nuk kanë dalë aktet normative, pse nuk i ke propozuar apo dërguar përfaqësuesit të dikasterit. Në qoftë se duhen miratuar me firmën e tij, le t'i miratojë, ose nëse duhen miratuar me VKM, le të shkojnë në Këshillin e Ministrave.

Makineria e shtetit të vërtetë nuk është ministri dhe as mbledhja e qeverisë, por administrata e shtetit, ku ju jeni drejtues. Gjëja e parë që duhet të bësh kur del një ligj nga parlamenti është të pyesësh se cila është detyra ime dhe çfarë duhet të bëj unë për këtë. Detyra e parë janë aktet normative, të cilat duhet t'i inicioni ju e para bashkë me gjithë administratën tënde.

Po, zonja avokate.

Erinda Ballanca – Faleminderit!

Në fakt, puna për bërjen e këtij raporti dhe praktika për ta trajtuar fillimisht raportin si një draft-raport është një praktikë shumë e mirë, pasi ky është një nga të paktat raporte që diskutohen me publikun përpara sesa të dërgohen nga ana e qeverisë. Nuk ka ndodhur e njëjta gjë në raste të tjera dhe prandaj është një praktikë për t'u vlerësuar.

Në lidhje me raportimin, për të mos qenë përsëritës, nuk mund të mos e konsiderojmë një problem dhe duhen identifikuar personat përgjegjës se përse ky raportim po vjen me vonesë. Pra, nëse ne nuk do të mbajmë përgjegjësi apo nuk do të ngarkojmë personat me përgjegjësi administrative, të jeni të bindur që ky gabim do të ribëhet dhe do të vijmë përsëri në momentin tjetër të raportimit me të njëjtat problematika.

Unë e kuptoj që problemi kryesor janë kapacitetet njerëzore për përgatitjen e këtyre projekteve dhe për krijimin e strukturave që duhet të jenë në administratën tonë shtetërore apo

lokale me një vëmendje të veçantë për këto lloj raportimesh. Unë e shikoj në institucionin tim si një problem thelbësor këtë gjë dhe e kam kërkuar për 2 vjet në Kuvend duke thënë se duhet krijuar një strukturë brenda secilës prej organeve të administratës shtetërore, për të pasur në vëmendje raportimet e këtij lloji. Ju, sigurisht, e keni në ministrinë tuaj, por përsëri keni vetëm përmbledhës informacioni dhe nuk keni njerëz, që të dinë kontentin. Kontenti duhet të jetë në secilën prej strukturave të administratës shtetërore. Nga leximi pjesor që i kemi bërë raportit (do ta shikojmë përsëri, për komente të mëtejshme) më rezulton se për punën e institucionit tonë janë adresuar vetëm një pjesë e komenteve që janë bërë, si të thuash, është raportuar vetëm për një pjesë të kërkesave që ka pasur komiteti, duke zgjedhur të heshtni për një pjesë të kërkesave apo të pyetjeve të tjera, që janë drejtuar dhe për të cilat duhet të raportoni. Fatmirësisht, është krijuar një seksion i veçantë në zyrën e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve... Njohja e kapaciteteve teknike dhe atyre financiare, për buxhetin që ky institucion duhet të ketë për ta ushtruar realisht këtë detyrë, përbën një ecuri pozitive.

Nga ana tjetër, duket se roli i agjencisë duhet të jetë lider. Sigurisht që duhet një kohë e caktuar që të krijohen këto kapacitete, pra u krijua institucioni, kishin një drejtues të agjencisë, tani ka një drejtues... Do të duhet që njerëzit të trajnohen gjithmonë, por vëmendja e gjithsecilit kur fillon dhe kryen punën duhet të jetë në zbatimin e konventës, të interesit më të lartë të fëmijëve dhe në trajtimin e çdo problematike në këtë këndvështrim.

Shoqëria shqiptare, për shkak të miratimit të konventës, duhet të bëjë një ndryshim tërësor në mentalitetin e saj. Deri tani familja është konsideruar si interesi më i lartë i fëmijës, por ndryshimet që janë bërë tregojnë një rol më aktiv të shtetit për mbrojtjen e interesave të këtyre fëmijëve. Ky raport duhet të forcohet gjithnjë e më tepër. Kur them “roli i shtetit”, e kam fjalën për krijimin e strukturave, për t’i çuar këta fëmijë në familjet kujdestare apo për t’u gjetur mjediset e tjera alternative. Ky rol duhet të jetë raporti i vërtetë dhe jo vetëm bërja e ligjeve.

Është e vërtetë që familjet kujdestare dhe identifikimi i individëve brenda familjes është një gjë shumë e rëndësishme për fëmijët, të cilët janë në situata të dhunës psikologjike apo në situata në të cilat ata nuk mund të jetojnë.

Lind pyetja: sa procedura gjyqësore kanë përfunduar që kur ka hyrë ligji në fuqi? Dhënia e kujdestarisë për këta fëmijë është vërtet një ushtrim pothuajse i pamundur për gjykatat shqiptare, aq sa duke u krijuar kjo situatë njerëzit nuk tentojnë për ta pasur kujdestarinë alternative.

Këto janë realisht probleme, të cilat duhet të adresohen në mënyrë të qenësishme.

Megjithatë, për të mos marrë më tepër kohë, detyrat që secili prej nesh duhet të bëjë nga ky raportim në tjetrin, duhet të jenë të modeluara, për të adresuar rast pas rasti komentet që janë bërë, pasi ato janë udhërrëfyese në punën tonë për të përmirësuar standardet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Ju falënderojmë!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Urdhëro!

Klodiana Spahiu – Faleminderit për këtë seancë të shpejtë, menjëherë pas miratimit të rezolutës!

Faleminderit edhe shoqërisë civile, që në çdo moment ka qenë shumë pranë nesh, për të na dhënë raporte të caktuara, të cilat na kanë shërbyer çdo ditë në punën tonë për përmirësimin e jetës së fëmijëve!

Kisha një propozim, meqenëse jemi mbledhur disa herë me grupin “Miqtë e fëmijëve”. Të fillojmë të funksionojmë secili si komitet më vete, sepse ndoshta kështu edhe raportin do të mund ta analizonim më mirë, sepse...*(nuk dëgjohet)* për problemet shëndetësore funksionon...*(nuk dëgjohet)* i vogël. Mendoj që duhet të jemi më konkretë dhe...*(nuk dëgjohet)*.

Përveç kësaj, kisha dy-tri gjëra ku duhet të fokusohemi më tepër.

E kam lexuar raportin e ministrisë. Do të doja ta falënderoja për çdo gjë që është arritur deri tani, por ne duhet të bazohemi pak te raportet ndërkombëtare! Po bazohem te një raport i LANCE, i botuar ditët e fundit, për shëndetin e adoleshentëve. Aty vërehet se problematikat për shëndetin e adoleshentëve janë në shtim. Mendoj që një trend i tillë është edhe në vendin tonë. Duhet të fokusohemi më shumë në dy-tre problematika kryesore, siç janë mbipesha dhe obeziteti, pirja e duhanit, shëndeti seksual dhe planifikimi familjar.

(Nuk dëgjohet)... një problem që u ngrit këtu për fëmijët e familjeve me ndihmë ekonomike. Nëse do të ishte e mundur, edhe në bashkëpunim me shoqërinë civile...*(nuk dëgjohet)* shëndetin oral, shëndetin e dhëmbëve dhe gojës së fëmijëve, me jodizimin e kripës, që u përmend edhe këtu, si dhe në problemin e shëndetit të shtyllës kurrizore. Është një problem shumë i vogël, që duhet të evidentohet që në vitet të para të shkollës, sepse fillojnë deformime, të cilat më kalimin e moshës mund të bëhen të pariparueshme.

Në qoftë se ne përpiqemi më shumë, se jo çdo gjë mund t'ia kërkojmë vetëm qeverisë, por në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me shoqërinë civile... Ju na keni dhënë ide dhe keni projekte të jashtëzakonshme. Kështu që shpresoj në këtë bashkëpunim...*(nuk dëgjohet)* për fëmijët e këtyre familjeve që mund të jenë...*(nuk dëgjohet)*.

Do të doja të mbështesja edhe projekte... Për shembull, një nga projektet ku dua të fokusohem është ai i UNICEF-it për bashkitë miqësore për fëmijët.

Pushteti lokal ka një rol shumë të rëndësishëm tashmë. Shpresoj që edhe në zgjedhjet e ardhshme lokale ky të jetë pikësynimi i secilit drejtues të pushtetit lokal, që t'i trajtojë fëmijët me një sy tjetër, për të pasur me të vërtet një qytet miqësor për fëmijët në të gjitha aspektet.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni!

Anila Meço – Faleminderit, zoti Kryetar!

Jam Anila Meço nga “Save the Children”.

Pa përsëritur parafolësit, dua të fokusohem te diçka shumë pozitive që ne kemi vënë re te ky raport, te roli i konsultimit të fëmijëve gjatë përgatitjes së këtij raporti, që është edhe evident në draftin që kemi parë.

Doja të ngrija shumë shkurt vetëm dy problematika.

Evidentohet qartë gjithë përmirësimi që është bërë, më së shumti, në kuadrin ligjor, që prek jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Pak është shpjeguar se si është situata e fëmijëve me aftësi të kufizuara akoma edhe sot, sepse shumë nga këto përmirësime ligjore kanë nevojë ta japin efektin në jetën e tyre dhe ka problematika, me të cilat ata përballen ende dhe që janë madhore për jetën e tyre.

E dyta, që dua të përmend, është punësimi i të miturve. Ky problem është ngritur, siç u shpjegua edhe nga zëvendësministrja, por ka problematika në mbledhjen e të dhënave dhe në evidentimin e situatës ekzakte dhe ndoshta duhet të ketë fokusin e institucioneve shtetërore dhe të shikohet se si mund të njihet më mirë situata reale dhe në çfarë niveli është punësimi i të miturve sot.

Faleminderit!

Romina Kuko – Faleminderit, zoti kryetar!

Pa e zgatur, duke qenë se këtu u përmend disa herë roli i pushtetit vendor, mendoj se zbatimi i të gjitha rekomandimeve është përgjegjësi e bashkive. Dua t'ju informoj se si Ministri e

Brendshme e mbështesim atë që ju përmendët më parë për nxjerrjen e akteve nënligjore. Ne bëjmë politikën e nxjerrjes së ligjeve, por u takon sektorëve të propozojnë aktet nënligjore në zbatim të ligjeve organike dhe sektoriale për shkak të specifikës që ato kanë dhe se drejtoritë juridike, në çdo institucion, nuk janë në gjendje të kapin teknikalitetet e duhura. Ne kemi ndërmarrë një studim të ndihmuar nga Bashkimi Europian për secilin ministri dhe secilin institucion për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku shërbimi parësor shëndetësor dhe arsimi parashkollor janë kompetencë e deleguar e bashkive. E vërtetë është që kemi pasur një vështirësi të madhe për mbledhjen e të dhënave nga bashkitë edhe pas presionit që kemi bërë, pozitiv, kuptohet, nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore. Pas takimit të sotëm ne do të bëjmë një takim me bashkitë, së bashku me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për t’u vënë në dukje këto problematika. Nga ana juaj do të kërkoj që edhe Kuvendi të japë mbështetjen nëpërmjet Nënkomisionit për Çështjet Vendore, ku është kryetar zoti Fino, qoftë për të monitoruar procesin, qoftë për të kërkuar njëfarë llogarillënie nga ana e bashkive, në mënyrë që edhe ne të mundemi të mbledhim informacionin e nevojshëm, por, gjithashtu, të kemi edhe një llogaridhënie më të shtuar për këtë çështje.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Kush e do fjalën? Nuk ka.

Duke ju falënderuar për të gjithë kontributin e dhënë me diskutimet gjatë dëgjësës për kuadrin e përgatitjes së këtij raporti, kam tri sugjerime të fundit në kuadër të përmirësimit të punës:

E para, grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” duhet të rakordojë më mirë me grupin ndërministror të punës, të cilin e kemi sot këtu, që nëpërmjet ministrive të linjës, në bashkëpunim me deputetët e grupit “Miqtë e fëmijëve”, të bashkëpunojnë që, minimalisht, në dy vjetët e ardhshëm, që është periudha ndërmjet diskutimit dhe dorëzimit të këtij raporti, Kuvendi të ketë një listë të nismave ligjore, me qëllim që, deri në përmbyllje të rekomandimeve, ne, si grup deputetësh, duhet të përmbushim, së pari, misionin që kemi si ligjvënës në funksion të kësaj çështjeje, për të cilën jemi mbledhur.

Së dyti, është gjë shumë e mirë që u bë kjo dëgjësë, por të mos jetë as e para dhe as e fundit. Ne, si grup i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” duhet të planifikojmë seanca dëgjimore për raportimin e zbatimit afatmesëm të Axfendës Kombëtare të Fëmijëve.

E treta, siç e përsërita, ky është raporti i pestë dhe pavarësisht nga vonesa, do të dorëzohet shumë shpejt, siç u raportua edhe në Gjenevë, por çështja është se nuk duhet ta konsiderojmë punën dhe veprimtarinë tonë të mbyllur këtu, pra, dorëzuam raportin dhe përmbushëm detyrën. Siç u tha edhe këtu, perioda nga dorëzimi i raportit, deri te data që shqyrtohet raporti, është 2 vjet. Ky 2-vjeçar nuk duhet të jetë vakancë për ne, që të konsumojmë kohën, por, përkundrazi, të jemi kontributorë, në kuptimin që, deri në ditën që do të analizohet ky raport, çfarë do të plotësojmë në ato që nuk kemi bërë dhe nga këto që u thanë këtu, qoftë nga raporti, edhe nga diskutimet e folësve.

Faleminderit!

Mirë u takofshim në mbledhjet e radhës!